

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E MBROJTJES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **217-24-1226-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Shërbimet e mirëmbajtjes teknike të objektit të MM-së, dhe infrastrukturës përcjellëse**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

**"Lani-AL" SH.P.K**

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

**Rr. Hyzri Talla, nr 36-1. Prishtinë**

(Adresa)

**Prishtinë**

(Vendi)

**+383 49610088**

(Numri Telefonit)

**10000**

(Kodi postar)

(Numri i Faks-it)

**DRITAN UKAJ**

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

**lanial.company@gmail.com**

(Adresa elektronike)

**02.05.2024**

(Data e parashtrimit të ankesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

#### 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 22.02.2024

Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara: 26.02.2024

Hapja e tenderëve: 04.04.2024

Njoftimi mbi vendimin e AK: 19.04.2024

Kërkesë për rishqyrtim ndaj vendimit të AK: 23.04.2024

Pezullimi i aktivitetit të prokurimit: 24.04.2024

Njoftim mbi refuzimin e ankesës për rishqyrtim: 26.04.2024

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☐

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☐

### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

*A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po ☐

Jo ☐

*Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.*

## **7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**Neni 7 – Barazia në trajtim / Jo-Diskriminimi**

**Neni 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve**

**Neni 69 – Aftësia Teknike dhe/ose profesionale**

**Neni 70 i LPP-së – Standardet për çilesimin e sigurisë**

**Neni 26 i Rregullores Nr 001/2022 për prokurimin publik, konkretisht: paragrafi 26.6**

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## **8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Te nderuar:

Me datë: 23.04.2024 në OE "Lani-AL" SH.P.K pas qasjes në dokumente kemi bërë Kërkesë për Rishqyrtim pasi që AK nuk ka respektuar ligjet dhe rregulloren në fuqi të Prokurimit Publik.

Me datë: 26.04.2024 kemi pranuar përgjigjen mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim dhe atë me keto arsye:

Shkurtimisht përgjigjet e AK:

**Përgjigje për pretendimin 1.**

AK ka përmendur vetëm plotësim ndryshimet e ligjeve në fuqi dhe është thirrur në Nenin 66, paragrafi 66.2 Nëse lëndë e aktivitetit të prokurimit është kontrata publike që përfshin ofrimin e shërbimeve profesionale, dhe nëse këto shërbime i takojnë llojit që normalisht mund të ofrohen vetëm nga operatori ekonomik që ka autorizimin ose licencën e autoritetit publik ose që është



anëtar i organizatës së caktuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të ofrojnë dëshmi të arsyeshme se ata kanë autorizimin ose licencën e tillë ose se janë anëtarë në vendin e tyre të themelimit ose deklaraten nën betim se një kërkesë e tillë nuk ekziston në vendin e tyre të themelimit.

**Pra Neni 66.2 ka të bëjë me një aktivitet të prokurimit që përfshin ofrimin e shërbimeve profesionale ndërsa në rastin tonë ky aktivitet i prokurimit nuk ka të bëjë me shërbimet profesionale.**

**Rrjedhimisht edhe në nenet tjera që është thirrur AK nuk kanë të bëjnë me Standardet për Sigurimin e Cilësis (në këtë rast ISO 9001 2015 dhe 45001 2018)**

**Ky pretendim është ngritur nga ne sipas Nenit 70 të LPP pikerisht për Standardet për Sigurimin e Cilësis gjithashtu duke u bazuar edhe në nenin 26, paragrafi 26.6 i Rregullores nr. 001/2022 PËR PROKURIM PUBLIK.**

**Prandaj GOE OK Group SH.P.K & N.P.T "Bamirs" është i përgjegjshëm.**

### **Përgjigje për pretendimin 2.**

AK në këtë pikë ka treguar vetëm se në cilën pikë me nr. rendor gjendet stafi dhe CV e grupit të OE të shpallur fitues (të cilat ne i dim sepse për atë qëllim edhe kemi kërkuar qasje dhe kemi bërë kërkesë për rishqyrtim).

Me këtë AK e përserit se CV është e nënshkruar sipas kriterëve se dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontratë duke mos e arsyetuar CV-në e cila është paraqitur si KOPJE. Pra nuk është sipas kërkesave të dosjes se tenderit.

**Prandaj GOE OK Group SH.P.K & N.P.T "Bamirs" është i përgjegjshëm.**

### **Përgjigje për pretendimin 3.**

AK thotë se në pikën me nr. rendor 11 dhe 11.1 gjendet marrëveshja e nënshkruar në mesë të dy palëve sipas kërkesës 17.

Këtu shihet se AK është i jo i sakt në përgjigjen e pretendimeve tona sepse në ofertën e GOE OE OK Group SH.P.K & N.P.T "Bamirs" me nr. rendor 11 janë dy marrëveshje të cilat janë të nënshkruara për makinerinë për të cilat ne nuk kemi ngritur ndonjë pretendim, e ato janë:

1. Autobetonier mikser me 2 dyer, 04-518-JR (për të cilin ne nuk kemi pasur ndonjë verejtje)
2. Autobetonier mikser me 2 dyer, 04-519-JR (për të cilin ne nuk kemi pasur ndonjë verejtje)

Në marrëveshjen tjetër është kjo makineri:

1. Kamion me korpë, 04-791-DM (për të cilin ne nuk kemi pasur ndonjë verejtje)

Ndërsa në pikën 11.2 (jo 11.1 siç e paraqet AK) është e paraqitur lista e mjeteve të punës në të cilën nuk figurojnë makineritë të cilat ne i kemi ngritur si pretendime.

Pra AK është përgjigjur për pjesën e makinerisë për të cilat ne fare nuk i kemi diskutur ndërsa (në mungesë të argumentit dhe provave për të paraqitur ato me fakte) nuk është përgjigjur fare në pretendimet tona për makineritë që nuk janë paraqitur në ofertë e as në listën e makinerisë, e të cilat kanë qenë pjesë e kërkesave në dosjen e tenderit. Është e qartë se edhe pse GOE OK Group SH.P.K & N.P.T "Bamirs" nuk i ka paraqitur keto makineri (të përmendura në kërkesën për rishqyrtim), AK insiston se është i përgjegjshëm vetëm duke u thirrur në qmimin me të lirë në çdo përgjigje.

Atëherë përse janë paraqitur kriteret tjera në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë mëqenëse qenka "vetëm qmimi me të lirë"?

Prandaj ne si OE ankues mbetemi të habitur me përgjigjet e AK mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim sepse janë përgjigje nënqumuese dhe jo profesionale.

Se pari sa i përket OE VISAR KUQI B.I, AK e ka eliminuar nga ky AP sepse mungon sigurimi i tenderit.

Sigurimi i Tenderit mungon apo nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjese e DT Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm 57.

Gjithashtu sa i përket stafit profesional, konkretisht Ing. i diplomuar i ndertimtarisë/konstruktiv nuk e ka të nënshkruar CV ashtu siç është kërkuar në DT. Pra nuk e ka nënshkruar fare CV-në. **CV personale origjinale e nënshkruar nga vet inxhinieri, duhet të përmbajë të dhënat personal, kontaktin, e-mail, nr telefoni, përvojën e punës,.**

CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat - Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm 69

Sa i përket Grupit të OE: OK Group SH.P.K & N.P.T "Bamirs"

#### Neni 7 – Barazia në trajtim / Jo-Diskriminimi

AK gjatë vlersimit të tenderëve nuk ka qenë i barabartë në trajtim duke i anashkaluar gabimet e OK Group SH.P.K & N.P.T "Bamirs" të cilin e shpallur fitues.

#### Neni 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

AK gjatë ekzaminimit, vlersimit dhe krahasimit të tenderëve ka bërë disa gabime të cilat janë në kundërshtim me LPP-në, Rregulloren 001/2022 dhe Udhëzuesin, siç janë:

AK në DT konkretisht pika 7.1 & 7.2 Kërkesat e përshtatshmerisë profesionale dhe si deshmi dokumentare ka kërkuar: ISO Standarde, Çertifikimi i sistemit për menagjimin e cilsis. ISO 9001 - 2015 dhe ISO Standarde, Sistemi i menagjimit të shendetit dhe sigurisë në punë. ISO 45001 – 2018, ndërsa OE OK Group SH.P.K (lider i Grupit) nuk i ka ngarkuar fare keto dy ISO Standarde duke e mos plotësuar kriterin e larë cekur sipas DT. Pra mungojnë ISO Standardet e OK Group SH.P.K Në bazë të kësaj AK ka shkelur edhe nenin 70 të LPP-së dhe nenin 26 Rregullores Nr 001/2022 për prokurimin publik, konkretisht: paragrafi 26.6 i cila thotë: Çertifikatat për sigurimin e cilesisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim vërtetimin e përputhmërisë së operatorit ekonomik me një numer të caktuar standardesh për sigurimin e cilesisë. Nëse AK kërkon çertifikata të hartuara nga organe të pavaruara që kryejnë aktivitete të çertifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilesisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombetare, secili anëtar i grupit do të deshmojë se i përmbush standardet përkatëse.

Dhe jo vetëm kjo, sepse AK në DT këto ISO Standarde i ka kërkuar të kërkesat e përshtatshmerisë profesionale që d.m.th secili anëtar i grupit duhet të paraqesë në hapjen e tenderëve, dhe sipas kësaj del se lideri i grupit OK Group SH.P.K nuk i përmbush kërkesat e DT dhe si rezultat duhet eliminuar nga ky AP.

#### Neni 69 – Aftësia Teknike dhe/ose profesionale

AK në DT, konkretisht pika 9.1 & 9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale si deshmi dokumentare ka kërkuar:

- Diploma kopje e Noterizuar**
- CV personale origjinale e nënshkruar nga vet inxhinieri, duhet të përmbajë të dhënat personal, kontaktin, e-mail, nr telefoni, përvojën e punës,.**
- Te dëshmohet marrëdhënia e punës me kontratë valide ose para kontratë me emër të projektit, e nënshkruar**



Sa i përket Ing. I diplomuar i ndërtimtartisë/Hidroteknik - Musli Shala, Tek pika b. CV personale "originale" e nënshkruar nga vet inxhinieri, OE OK Group SH.P.K ka paraqitur një CV JO ORIGINALE, por CV kopje e nënshkruar të inxhinierit Musli Shala.

Pra OE i shpallur fitues nuk e ka prezantuar CV origjinale të inxhinierit në fjalë por CV kopje dhe si rezultat nuk i përmbush kërkesat e DT dhe duhet eliminuar nga ky AP sepse ka shkelur nenin 69 të LPP-së (Shih Udhezuesin 001/2023) **CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat - Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtjshëm 69**

Sa i përket kësaj pike: Ing. i diplomuar i Elektroteknikës dhe Ing. i diplomuar i Makinerisë nuk figurojnë askund në Listen e stafit apo punëtorëve.

Tek pika 9.1 & 9.2, Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, Kërkesa 17. AK në DT ka kërkuar: **Kërkesa 17. OE duhet të paraqes raportin për mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë në dispozicionin tuaj për realizimin e projektit të punëve ose përmbushjen e aktiviteteve. Eskavator 3 deri 5 ton 1 Cope. Cilinder 1 Cope Kamion kiper me pesh bartese e ngarkeses 8 deri 10 ton 1 Cope Kamion me korp 1 Cope Kamionet kiper me pesh bartese 3 deri 4 tone 1 Cope Automjet për bartje te betonit - mikser 1 Cope Mjetet tjera të nevojshme në bazë të specifikave të kontrates.**

**AK ka kërkuar Kamion kiper me peshë bartëse e ngarkeses 8 deri 10 ton 1 copë.** Grupi i OE OK Group SH.P.K & N.P.T "Bamirs" i shpallur fitues nuk e ka paraqitur fare në ofertë këtë kërkesë gjithashtu as edhe në listë të makinerisë. Grupi i OE OK Group SH.P.K & N.P.T "Bamirs" i shpallur fitues ka paraqitur 2(dy) kamion dhe 1(një) kokë terheqese në ofertën e tyre me targa:

1. 04-250-CE (Kamion i rëndë me 2 dyer) / **Pesha maksimale e ngarkeses se lejuar: 15480** (nuk e plotëson kërkesën sipas DT-së sepse e tejkalon pesën e kërkuar)

2. 04-824-FL (KAMION I RËNDË me 2 dyer) / **Pesha maksimale e ngarkeses se lejuar: 3430** (nuk e plotëson kërkesën sipas DT-së sepse është me pak se pesha e kërkuar).

3. 04-956-HB (Kokë terheqese me 2 dyer) / **Pesha maksimale e ngarkeses se lejuar: 10850** (nuk e plotëson kërkesën sipas DT-së sepse e tejkalon pesën e kërkuar), gjithashtu nuk është kamion kiper por vetëm kokë terheqese që nuk shërben për qelimin që e ka vendosur AK.

**Si përfundim asnjë kamion kiper me pesh bartëse e ngarkeses 8 deri 10 ton nuk është paraqitur në ofertë e as në listën e makinerisë të Grupit të OE OK Group SH.P.K & N.P.T "Bamirs"**

**AK ka kërkuar Kamionet kiper me pesh bartese 3 deri 4 tone 1 copë,** ndërsa Grupi i OE OK Group SH.P.K & N.P.T "Bamirs" i shpallur fitues nuk ka paraqitur Kamionet kiper me këto specifika.

1. 04-826-HJ (kamionetë dubelkabinë 4 dyer) / **Pesha maksimale e ngarkeses se lejuar: 1404** (nuk e plotëson kërkesën sipas DT-së sepse është me pak se pesha e kërkuar, gjithashtu ka afat të skaduar të regjistrimit (17.03.2024) ndërsa data e hapjes së tenderve ka qenë: 04.04.2024)

2. 04-791-FL (kamionetë dubelkabinë 3 dyer)/ **Pesha maksimale e ngarkeses se lejuar: 1442** (nuk e plotëson kërkesën sipas DT-së sepse është me pak se pesha e kërkuar, gjithashtu ka afat të skaduar të regjistrimit (02.03.2024) ndërsa data e hapjes së tenderve ka qenë: 04.04.2024)

**Pra nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit prandaj është i papërgjegjshëm.**

Duke u bazuar në faktet dhe argumentet tona kërkojm nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të:

**APROVOHET** si e bazuar ankesa jonë,

**ANULOHET** B58 Njoftimi mbi vendimin e AK për dhënjen e kontratës dhe lënda të kthehet në **RIVLERSIM** sepse GOE OK Group SH.P.K & N.P.T "Bamirs" i propozuar për kontratë është i papërgjegjshëm pasi nuk i ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Me respekt.

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

--

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përfundim me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përfundim me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

Titulli: Shërbimet e mirëmbajtjes teknike të objektit të MM-së, dhe infrastrukturës përcjellëse  
Nr i prokurimit: 217-24-1226-2-1-1, Nr i brendshëm: 217-24-006-2-1-1

MINISTRIA E MBROJTJES

## DOSJA E TENDERIT PËR KONTRATËN PUBLIKE KORNIZË – SHËRBIM

### Me Një Operator Ekonomik

*Sipas Nenit 27 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

### PROCEDURË E HAPUR

22.02.2024

Data kur është përgatitur Dosja e Tenderit:

Nr i prokurimit	217-24-1226-2-1-1
Nr i brendshëm	217-24-006-2-1-1

Titulli: Shërbimet e mirëmbajtjes teknike të objektit të MM-së, dhe infrastrukturës përcjellëse  
KJO DOSJE E TENDERIT PERBEHET PREJ TRI PJESËVE:

Pjesa A: Procedurat e tenderimit që përmbajnë udhëzime për përgatitjen e tenderit;

Pjesa B: Draft Kontrata që përmban kushtet kontraktuese të cilat duhet t'i pranojë tenderuesi që merr kontratën; dhe

Pjesa C: Formulari i Tenderit, d.m.th. dokumentet që duhet t'i paraqesin tenderuesit

Kjo dosje e tenderit është përgatitur në gjuhët Shqipe, Serbe "[dhe Angleze]".

Ne rast se ka mospërputhje në mes versioneve gjuhësore, versioni i gjuhës Shqipe do të mbizotëron.

<sup>1</sup> Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit



Titulli: Shërbimet e mirëmbajtjes teknike të objektit të MM-së, dhe infrastrukturës përcjellëse  
Nr i prokurimit: 217-24-1226-2-1-1, Nr i brendshëm: 217-24-006-2-1-1

**TEMA: FTESE PËR TENDER për kontratën publike kornizë për ekzekutim të, '[specifiko shërbimet]':**

**Shërbimet e mirëmbajtjes teknike të objektit të MM-së, dhe infrastrukturës përcjellëse**

Ju faleminderit për interesimin e juaj për pjesëmarrje në aktivitetin e lartë përmendur të prokurimit.

Sipas kërkesës suaj, ju lutem gjeni të bashkangjitur dokumentet, të cilat përbëjnë Dosjen e Tenderit.

Nga ju pritet që të ekzaminoni me kujdes të gjitha pjesët, nenet dhe anekset e kësaj dosjeje të tenderit dhe të pajtoheni me të gjitha kërkesat, specifikimet dhe kushtet e përfshira këtu.

Ne, si Autoritet Kontraktues nuk pranojmë asnjë ndryshim.

Në rast të dështimit të dorëzimit të tenderin tek autoriteti kontraktues brenda afatit të caktuar në Dosjen e Tenderit, dhe/apo nuk është pajtim me të gjitha kërkesat e paraqitura në dosjen e tenderit, do të refuzohet dhe do të konsiderohet si *"tender i papërgjegjshëm"*

Të gjitha shpenzimet që lidhen me përgatitjen dhe me dorëzimin e tenderit duhet të barten nga tenderuesi, ndërsa autoriteti kontraktues nuk do të ketë asnjë detyrim në rast se anulohet procedura

Kjo procedure e tenderimit është e rregulluar me Ligjin e Prokurimit Publik ( Nr. 04/L-042 , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe rregullave të prokurimit të nxjerra në përputhshmëri me të.

LPP-ja dhe Rregullat e Prokurimit mund të shkarkohen nga web-faqja e Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP): [www.krpp.rks-gov.net](http://www.krpp.rks-gov.net).

Tenderët duhet të dorëzohen në adresën e specifikuar në pjesën A "Procedurat e Tenderimit para

**04.04.2024** në **14:00:00** orë.

Me dorëzimin e tenderit, tenderuesi pranon në mënyrë të plotë dhe pa rezervime, kushtet e veçanta dhe të përgjithshme që rregullojnë këtë kontratë të propozuar si një bazë të vetme të kësaj procedure të tenderimit.

Mirëpresim pranimin e Tenderit tuaj.

Nëse vendosni të mos e dorëzoni tenderin, do të ishim mirënjohës nëse do të na lajmëronit me shkrim, duke cekur arsyet e vendimit të juaj.

Me sinjeritet,

Emri dhe Mbiemri:

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

MINISTRIA E MBROJTJES

## NJOFTIM PËR KONTRATË

☐ PUNË

☐ FURNIZIM

☒ SHËRBIME

*Sipas Nenit 40të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Data e përgatitjes së njoftimit: 22.02.2024

Nr i Prokurimit	217-24-1226-2-1-1
Nr i brendshëm	

Ky njoftim është përgatitur në Gjuhët:

Shqip



Serbisht



Anglisht



### NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

#### I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: MINISTRIA E MBROJTJES		
Adresa Postare: Kazerma Adem Jashari		
Qyteti: PRISHTINË	Kodi postar: 10000	Vendi: Kosovë
Personi kontaktues: Muhamet Xhylani		Telefoni: 03820013501
Email: Muhamet.xhylani@rks-gov.net		Faksi: 03820013560
Adresa e Internetit (nëse aplikohet): <a href="https://mod.rks-gov.net/">https://mod.rks-gov.net/</a>		

Po ☐ Jo ☒

Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët

Po ☐ Jo ☒

Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

*Nëse po, specifiko identitetin e të gjithë Autoriteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referojnë një Aneksi:*

### NENI II: LËNDA E KONTRATËS

## II.1) PËRSHKRIMI

### II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:

Shërbimet e mirëmbajtjes teknike të objektit të MM-së, dhe infrastrukturës përcjellëse

### II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit

(Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)

<input type="checkbox"/> Punë	<input type="checkbox"/> Furnizime	<input checked="" type="checkbox"/> Shërbime
<input type="checkbox"/> Ekzekutim <input type="checkbox"/> Plani dhe ekzekutimi <input type="checkbox"/> Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa	<input type="checkbox"/> Blerja <input type="checkbox"/> Qira financiare (lizing) <input type="checkbox"/> Qira <input type="checkbox"/> Blerje me këste <input type="checkbox"/> Një kombinim i këtyre	

Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve/kryesor i dorëzimit/ kryesor i realizimit  
**MINISTRIA E MBROJTJES**

### II.1.3) Njoftimi përfshinë

Krijimin e kontratës publike kornizë



### II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë (nëse aplikohet):

Kontrate publike kornizë me një operator



Kontrate publike kornizë me disa operator



#### Ekzekutimi i kontratës:

Thirrje/Porosi



Kontrata ndihmëse/Mini-konkurencë



Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë: në muaj 36

### II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës

AK i MM, ka për qëllim që të lidhë një kontratë me një OE, që do të ketë kapacitet të kryej Shërbimet e mirëmbajtjes teknike të objektit të MM-së, dhe infrastrukturës përcjellëse. Realizimi i kontratës duhet të bëhet sipas specifikimit teknik të kerkuar dhe TeR të percaktuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Qëllim i realizimit të kësaj kontratë është ngritja e operacionalitetit dhe efikasitetit në kryerjen e detyrave sipas misionit të MM-së dhe FSK-se.



<b>II.1.6) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP):</b> 93000000-8								
<b>II.1.7) Variantet pranohen</b> Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>								
<b>II.1.8) Ndarja në Pjesë</b> Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>  Nëse <i>po</i> , tenderët mund të dorëzohen për (shënoni vetëm një kuti)  <input type="checkbox"/> vetëm një pjesë <input type="checkbox"/> Të gjitha pjesët								
<b>II.1.9) Informacione lidhur me pjesët (nëse aplikohen)</b> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse; margin-top: 10px;"> <thead> <tr> <th style="width: 15%;">Nr. i pjesës</th> <th style="width: 40%;">Emërtimi i grupit</th> <th style="width: 45%;">Përshkrimi i shkurtër</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td style="height: 20px;"></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>			Nr. i pjesës	Emërtimi i grupit	Përshkrimi i shkurtër			
Nr. i pjesës	Emërtimi i grupit	Përshkrimi i shkurtër						
Numri maksimal i Pjesëveqë do të mund të shpërblehet tek një tenderues është:								
<b>II.1.10) Vlera e parashikuar e kontratës: 400,000.00</b>								

## II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm (përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen)  
 Ju lutemi referojuni Dosjes së Tenderit

## II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM

Kohëzgjatja në muaj apo ditë (nga dhënia e kontratës)  
*apo*  
 Fillimi  
 Përfundimi

## NENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE

### III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN

#### III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimit

Po ☒ Jo ☐

Nëse *po*, vlera e sigurisë së ekzekutimit EUR ose 10% e vlerës së kontratës me kohzgjatje prej 37 Muaj % e vlerës së kontratës

#### III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t'u jepet kontrata (nëse aplikohet):

Sipas LPP-së

#### III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës

Po ☒ Jo ☐

Nëse po, përshkrimi i kushteve të veçanta

1. Te gjitha punët, shërbimet dhe furnizimet duhet të jenë të kualitetit të lartë dhe në përputhshmëri të plote me normat dhe standardet evropiane në fuqi, ISO –standardeve specifike të fushave përkatëse (Punë, shërbime, materiale dhe pajisje). 2. OE duhet të jetë i gatshëm për të kryer shërbimet e mirëmbajtjes – punëve pa kufizim kohore (në çdo kohë brenda 24-7 orëve duke llogaritur edhe ditët festive) sipas nevojave që paraqiten në objektin e MM-se në Prishtinë në përputhje me kushtet e kontratës. 3. Menaxheri i kontratës do të përcjell implementimin dhe kualitetin e shërbimeve dhe njeherit do të bëjë vlerësimin e shërbimeve të realizuara. 4. Sipas kërkesës në këtë DT specifikimet teknike të detyrueshme pika 3.1, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë 5.

Deklaratën me shkrim për specifikacionet teknike për shërbimet dhe artikujt e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit; 6. Kontrata do të hyjë në fuqi nga momenti i nënshkrimit të sajë dhe do të zgjasë 36 muaj apo 3 vite kurse për fillimin e shërbimeve të mirëmbajtjes - punëve do të fillojë të realizojë në afat prej max 3 orëve nga momenti i thirrjes (intervenimet duhet të jenë 24-7 duke llogaritur edhe ditët festive sipas kërkesës dhe nevojave të AK dhe në përputhje me specifikacionin teknik të dhënë në DT. 7. Vendi kryesor i realizimit të shërbimeve - punëve do të jetë në objektin e MM-se në Prishtinë. 8. OE është i obliguar që minimum një punëtorë duhet ta ketë në Objektin e MM-se çdo ditë pune nga ora 7.00h deri në 16.00 h në mënyrë që kujdeset për leshuarjen në punë të sistemit të nxemjes qendrore gjatë dimrit si dhe klimatizimit gjatë verës si dhe të kujdeset për riparimin e defekteve që ndodhin në objekte. VËREJTJE; Gjatë përgatitjes së specifikacionit teknik ka mundur që të përmendet emri i prodhuesit apo ndonjë element me emër të caktuar, mirëpo për ofertim vle

### III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

<b>III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:</b>  <b>Kërkesa 1</b> Deklaratë nën betim – OE duhet të përmbushë kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr. 04 L- 042 për Prokurimin Publik i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04 L-237, Ligjin Nr. 05 L-068 dhe Ligjin Nr. 05 L-092, Neni 65 duke përdorur formën në Aneksin 2.	<b>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</b>  <b>Evidenca 1</b> Deklaratë nën betim -duhet të dorëzohet e nënshkruar dhe i vëltur nga O. Ekonomik
<b>Kërkesa 2</b> OE duhet të ofrojë dëshmi nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.	<b>Evidenca 2</b> Vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore - duhet të dorëzohet vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës-
<b>Kërkesa 3.</b> OE duhet të ofrojë një formular ekstrakt nga “regjistri gjyqësor” apo, në mungesë të kësaj, një dokument ekuivalent të lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor apo administrativ i shtetit të themelimit të tenderuesit ku dëshmohet për Seksionin II. FLETA E TË DHËNAVE të Tenderit (FTD) të dosjes së tenderit të Pranueshmëria e (shiko dosjen e tenderit pjesën 6.4.)	<b>Evidenca 3</b> Vërtetimin nga Gjykata themelore - dorëzohet vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës
<b>III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:</b>  <b>Kërkesa 4.</b> Certifikata e regjistrimit të biznesit  <b>Kërkesa 5.</b> Certifikata e regjistrimit të TVSH-së <b>Kërkesa 6.</b> Certifikata e regjistrimit të numrit	<b>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</b>  <b>Evidenca 4.</b> Kopja e Certifikatës së regjistrimit të biznesit <b>Evidenca 5.</b> Kopja e Certifikatës së TVSH-së <b>Evidenca 6.</b> Kopja e Certifikatës me numër



fiskal	fiskal
Kërkesa 7. OE duhet të dëshmojë se është i certifikuar me ISO Standarde, Certifikimi i sistemit për menaxhimin e cilësisë ISO 9001 2015	Evidenca 7 Kopja e Certifikatave me ISO Standarde për produktet e kërkuar pjesë e këtij tenderi
Kërkesa 8. OE duhet të dëshmojë se është i certifikuar me ISO Standarde, Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë. ISO 45001 2018	Evidenca 8 Kopja e Certifikatave me ISO Standarde për produktet e kërkuar pjesë e këtij tenderi
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>
Kërkesa 9. Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë të hyrat e përgjithshme së bashku për tri vitet e fundit duhet të jenë minimum jo më pak se 600,000.00€	Evidenca 9. Raportin ose raportet përkatëse nga një ose më shumë banka mbi kapacitetin ekonomik dhe financiar nga ndonjë bankë e licencuar
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>
Kërkesa 10 OE duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjte (Mirmbajtje të Objekteve dhe Renovimeve) gjatë 3 (tri) viteve të fundit (nga data e publikimit të njoftimit për kontratë) jo më pak se 600,000.00 €;	Evidenca 10. OE duhet të ofrojë dëshmi a). Listën e kontratave të realizuara gjatë tri viteve të fundit (nga data e publikimit të këtij njoftimit për kontratë) e nënshkruar dhe vëlosur nga OE. b). Referencat ose fletet pranimit pranimit teknike në kopje të nënshkruar dhe vëlosur nga Autoriteti për përkatës të cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës, datën e nënshkrimit të kontratës, dhe vendin e realizimit. Vërejtje Asnjë kontratë nuk do të llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca pozitive për raportet e fletë pranimeve të furnizimeve shërbimeve puneve është bërë për një autoritet publik apo privat në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi duhet të dorëzohen fletëpranimit ose referencat (në referencat të jete e cekur vlera) të lëshuara nga autoriteti i tillë. Për referencat nga institucionet private duhet të dëshmohet qarkullimi i bankar origjinal nga banka për vlerën referencës së prezantuar
Kërkesa 11 OE duhet të ofrojë listën e të punësuarve me specifikimin e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik dhe, në veçanti, të personit ose personave që drejtpërdrejtë është ose janë përgjegjës për ofrimin e shërbimeve pjesë e këtij tenderi minimumi duhet të ketë 15 punëtor të kualifikuar në fushën e renovimeve dhe mirmbajtjes së objekteve. OE është i obliguar që minimum një punëtor duhet ta ketë në Objektin e MM-së çdo ditë pune nga ora 07.00h deri në 16.00 h në mënyrë që kujdeset për lëshuarjen në punë të sistemit të nxemjes qendrore gjatë dimrit si dhe klimatizimit gjatë verës si dhe të kujdeset për Evidencimin dhe riparimin e defekteve që mund të ndodhin në objekte gjatë ditës OE duhet të caktoj një menaxher të projektit, i cili duhet të	Evidenca 11 OE duhet të ofrojë dëshmi A) Listën e punëtorëve të kompanisë me të dhënat në vijim Emri, mbiemrin, moshën e punëtorit, profesionin, eksperiencën (vite) dhe pozicionin në kompani, e nënshkruar dhe i vëlosur nga OE B) Vendim me shkrim për caktimin e menaxherit të projektit - e nënshkruar dhe i vëlosur nga OE C) Për të gjithë stafin e kërkuar kopja e diplomave të Noterizuar, CV-it, si dhe kopja e kontratave të punës ose para kontratave me emër të projektit.



<p>jete inxhinier i diplomuar i ndertimtarise konstruktive sistemi 5 vjeçare ose Master i drejtimeve perkatëse. Munde te jete njeri nga stafi i cili duhet te jete inxhinier i diplomuar i ndertimtarise ,drejtimi konstruktivë.</p>	
<p>Kërkesa 12. Ing. dip. Ndërtimtarisë-konstruktiv me minimumi përvojë pune 3 vjeçare, min 1(sistem 5 vjeçar ose master)</p>	<p>Evidenca 12. a.Diploma kopje e Noterizuar b.CV personale origjinale e nënshkruar nga vet inxhinieri, duhet te përmbaj te dhënat personal, kontaktin, e-mail, nr telefoni, informata mbi shkollimin, fillimin dhe përfundimin e shkollimit te inxhinierit, përvojën e punës,. c. Te dëshmohet marrëdhënia e punës me kontratë valide ose para kontratë me emër te projektit, e nënshkruar</p>
<p>Kërkesa 13.Ing.dip.i Makinerisë ( Drejtimi Termoenergjetik) min 1 me minimumi përvojë pune 3 vjeçare (sistem 5 vjeçar ose master)</p>	<p>Evidenca 13. a.Diploma kopje e Noterizuar b.CV personale origjinale e nënshkruar nga vet inxhinieri, duhet te përmbaj te dhënat personal, kontaktin, e-mail, nr telefoni, informata mbi shkollimin, fillimin dhe përfundimin e shkollimit te inxhinierit, përvojën e punës,. c. Te dëshmohet marrëdhënia e punës me kontratë valide ose para kontratë me emër te projektit, e nënshkruar</p>
<p>Kërkesa 14.Ing.dip.i Ndertimtarise - (Hidroteknikes) min 1 me minimumi përvojë pune 3 vjeçare (sistem 5 vjeçar ose master)</p>	<p>Evidenca 14. a.Diploma kopje e Noterizuar b.CV personale origjinale e nënshkruar nga vet inxhinieri, duhet te përmbaj te dhënat personal, kontaktin, e-mail, nr telefoni, informata mbi shkollimin, fillimin dhe përfundimin e shkollimit te inxhinierit, përvojën e punës,. c. Te dëshmohet marrëdhënia e punës me kontratë valide ose para kontratë me emër te projektit, e nënshkruar</p>
<p>Kërkesa 15.Ing.dip.i Elektroteknikës - (Telekomunikim me kompjuterik) min 1 me minimumi përvojë pune 3 vjeçare (sistem 5 vjeçar ose master)</p>	<p>Evidenca 14. a.Diploma kopje e Noterizuar b.CV personale origjinale e nënshkruar nga vet inxhinieri, duhet te përmbaj te dhënat personal, kontaktin, e-mail, nr telefoni, informata mbi shkollimin, fillimin dhe përfundimin e shkollimit te inxhinierit, përvojën e punës,. c. Te dëshmohet marrëdhënia e punës me kontratë valide ose para kontratë me emër te projektit, e nënshkruar</p>
<p>Kërkesa 16.Ing.dip.i Arkitektures min 1 me minimumi përvojë pune 3 vjeçare (sistem 5 vjeçar ose master)</p>	<p>Evidenca 14. a.Diploma kopje e Noterizuar b.CV personale origjinale e nënshkruar nga vet inxhinieri, duhet te përmbaj te dhënat personal, kontaktin, e-mail, nr telefoni, informata mbi shkollimin, fillimin dhe përfundimin e shkollimit te inxhinierit, përvojën e punës,. c. Te dëshmohet marrëdhënia e punës me kontratë valide ose para kontratë me emër te projektit, e nënshkruar</p>
<p>Kërkesa 17. OE duhet te paraqes raportin për mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë</p>	<p>Evidenca 17. Dëshmi A) Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike, për te</p>

në dispozicionin tuaj për realizimin e projektit të punëve ose përmbushjen e aktiviteteve. Eskavator 3 deri 5 ton 1 Cope. Cilinder 1 Cope Kamion kiper me pesh bartese e ngarkeses 8 deri 10 ton 1 Cope Kamion me korp 1 Cope Kamionet kiper me pesh bartese 3 deri 4 tone 1 Cope Automjet për bartje te betonit - mikser 1 Cope Mjetet tjera të nevojshme në bazë të specifikave të kontrates.	cilat është kërkuar dhe të cilat I ka në dispozicion kompania, e nënshkruar dhe e vulosur; ose kontrata mbi marrjen me qera të pajisjeve, e nënshkruar dhe e vulosur nga të dy palët B) Libreza e regjistrimit të automjeteve të cilat regjistrohen, C) Pajisje qe nuk regjistrohen DUD doganor të lexueshëm D) Për pajisjet te cilat nuk kanë Libreza apo DUD-a duhet te sillet fatura e blerjes
Kërkesa 18. Deklaratën me shkrimi për specifikacionin teknike furnizimet punet shërbimet e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të DT	Evidenca 18 OË duhet te sjell nje deklarate me shkrim te nenshkruar dhe vulosur.

### III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE

Po ☐ Jo ☒

**III.3.1) Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar**

*Nëse po, referenca për ligjin, rregulloren apo dispozitën administrative përkatëse*

**III.3.2 Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve**

Po ☐ Jo ☒

## NENI IV: PROCEDURA

### IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

**IV.1.1) Lloji i procedurës**

☒ E hapur

☐ E kufizuar

☐ Konkurruese me negociata

☐ Kuotim i Çmimit

**IV.1.2) Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim (procedurë e kufizuar apo konkurruese me negociata)**

Në bazë të aplikacioneve të pranuar, më së shumti 6 kandidat do të ftohen për të dorëzuar tenderët e detajuar të kësaj kontrate. Nëse më shumë se 6 kandidat të përshtatshëm i plotësojnë kriteret e mësipërme të përzgjedhjes, përparësitë dhe dobësitë relevante të aplikacioneve të këtyre kandidatëve do të ri-ekzaminohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për procedurën e tenderit. Të vetmit faktorë të cilët do të mirren parasysh gjatë këtij ri-ekzaminimi janë:

**IV.1.3) Reduktimi i numrit të operatorëve gjatë negociatave (procedurë konkurruese me negociata)**

Udhëheq negociatat në faza të njëpasnjëshme

Po ☐ Jo ☐

në mënyrë që të zvogëlohet numri i tenderëve të negociuar

Autoritetet kontraktuese mund të shpërblejnë kontratat në bazë të tenderëve fillestarë pa negociata

Po	<input type="checkbox"/>	Jo	<input type="checkbox"/>
IV.1.4 Numri minimal i kandidateve te cilët do te ftohen qe te dorëzojnë Tenderët fillestar është:			
IV.1.5. Informata ne lidhje me ankandin elektronik			
Do te përdoret ankandi elektronik:	Po	<input type="checkbox"/>	Jo <input checked="" type="checkbox"/>
Informata shtese ne lidhje me ankandin elektronik:			

## IV.2) KRITERET E DHËNIES

<input checked="" type="checkbox"/>	Çmimi më i ulët
<input type="checkbox"/>	<i>ose</i> Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të
<div></div>	

## IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë	
Po	<input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>
Nëse po, Njoftim paraprak: i	
Publikime tjera (nëse aplikohen): i i	
Po	<input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>
Dokumentet me pages	
Nëse po, çmimi EUR Kushtet dhe metoda e pagesës:	
IV.3.2) Afati i fundit për praninë të tenderëve / aplikacioneve:	
data 04.04.2024 koha 14:00:00 vendi Permes sistemit te e-prokurimit	
IV.3.3) Afati kohor për dorëzimin e tenderëve / aplikacioneve është shkurtuar:	
<input type="checkbox"/> Po	<input checked="" type="checkbox"/> Jo
Nëse po, jep arsyetimin	
IV.3.4) A është e nevojshme siguria e tenderit:	
Po	<input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>
Nëse po, vlera e sigurisë së tenderit Sigurimi i Tenderit 4,000.00 Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë 120 apo muaj	
IV.3.5) Periudha e vlefshmërisë së tenderit:	
Deri më: data: ditët 90 apo muajt	



#### IV.3.6) Takimi për hapjen e tenderëve:

data 04.04.2024 koha 14:00:00 vendi Permes sistemit te e-prokurimit

### NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

#### V.1) ANKESAT

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 në adresën e specifikuar në Nenin I të këtij Njoftimi për kontratë.

#### V.2) INFORMACIONET SHITESË

**Shënim:** operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.

*Shtu informacione tjera: (si konferenca para-ofertuese, vizita në punishte etj)*

